

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6764
E martë, 22 nëntor 2022
çmimi 0.40 €

Propozimi franko-gjerman në dy faza, mashtrim ordiner!

FAQE 6

Behxhet Sh.
SHALA – BAJGORA



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ME NDËRMJETËSIMIN E JOSEP BORRELLIT, ALBIN KURTI DHE ALEKSANDËR VUÇIQ U TAKUAN NË BRUKSEL

S'KA MARRËVESHJE PËR TARGAT

Borrelli: Kurti nuk e pranoi propozimin tonë për targat, Vuçiqi po. Bëj thirrje që ky propozim të zbatohet



Ka përfunduar pa marrëveshje takimi në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili është ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian (BE). Ndërmjetësuesi i këtij takimi, Josep Borrell, ka thënë se Kurti nuk e ka pranuar propozimin e BE-së për targat, ndërsa Vuçiqi është pajtuar me këtë propozim. "Për hir të

transparencës, ne parashtruar një propozim që mund ta shmangete këtë situatë të rrezikshme. Presidenti Vuçiq e pranoi por, për fat të keq, kryeministri Kurti nuk e pranoi" ka deklaruar Borrelli, duke i bërë thirrje Kosovës që ta pranojë propozimin e BE-së për targat. Ndërsa kryeministri Albin Kurti e ka akuzuar Borrellin për heqjen dorë nga marrëveshja e madhe



SHTËPI, BIZNESE E RRUGË TË DËMTUARA NGA VËRSHIMET

FAQE 3



QERIM QERIMI ZGJEDHET REKTOR I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

VJEDHJA E RRYMËS MUND T'U KUSHTOJË KONSUMATORËVE DHE BUXHETIT RRETH 100 MILIONË EURO

F. 8

SPORT



ANGLIA E NIS FUQISHËM BOTËTORIN, SHKATËRRON 6-2 IRANIN

F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ukraina: Më shumë se 8 300 civilë të vrarë në luftë

KIEV, 21 NËNTOR - Më shumë se 8 300 civilë janë vrarë deri më tani në luftën e Rusisë kundër Ukrainës, thanë hetuesit në Kiev. Midis tyre, ishin 437 fëmijë, tha prokurori i përgjithshëm, Andriy Kostin, raporton agjencia ukrainase e lajmeve UNIAN. Sipas tij, më shumë se 11 000 njerëz u plagosën në luftën që ka hyrë në muajin e nëntë.

Në fillim të këtij muaji, gjeneral i lartë amerikan Mark Milley tha se rreth 100 000 ushtarë rusë dhe rreth 100 000 ukrainas ishin

vrarë ose plagosur në luftë, shifra më e lartë e përmendur deri më tani nga një zyrtar perëndimor. Ai tha se rreth 40 000 civilë kishin vdekur pasi u kapën në konflikt, por këto shifra nuk kanë mundur të konfirmohen në mënyrë të pavarur.

Kombet e Bashkuara kanë dokumentuar 7.8 milionë njerëz si refugjatë nga Ukraina në të gjithë Evropën, përfshirë Rusinë. Megjithatë, shifra nuk përfshin ata që janë detyruar të zhvendosen përbrenda Ukrainës.



Gjermania i ofron Polonisë raketa për mbrojtje të hapësirës ajrore



Berlin, 21 nëntor - Gjermania i ka ofruar Polonisë sisteme mbrojtëse Patriot dhe Eurofighters për mbrojtje të hapësirës ajrore. Kështu u tha medieve gjermane ministrja e Mbrojtjes, Christine Lambrecht. "Brenda aleancës ne duhet të pozicionohemi edhe më mirë sa i përket mbrojtjes ajrore. Kjo vlen veçanërisht për Poloninë, Sllovakinë dhe vendet baltike", tha ajo.

Ministri polak i Mbrojtjes, Mariusz Blaszczak, tha se ai e pranoi ofertën e Gjermanisë për raketa shtesë Patriot, dhe tha se do t'i vendosin ato pranë kufirit me Ukrainën.

Më 14 nëntor dy polakë u vranë kur një raketë goditi një depo gruri në fshatin Pzhevoduv, vetëm 6

kilometra nga kufiri me Ukrainën. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, deklaroi një ditë më pas se sulmi i së martës në Poloni me gjasë u shkaktua nga mbrojtja ajrore e Ukrainës, por shtoi se Rusia mbetet fajtores pasi ajo e nisi luftën.

Incidenti ndodhi gjatë asaj që Kiev i quajti valën më intensive të sulmeve ruse me raketa në qytete ukrainase që nga fillimi i luftës në shkurt.

Ukraina tha se i rrëzoi shumicën e raketave ruse përmes raketave të veta të mbrojtjes ajrore. Rajoni Volyn i Ukrainës, afër kufirit me Poloninë, ishte një nga të shumtët që ishte cak i sulmeve ruse, sipas Ukrainës.

Rusia ka hedhur rreth 4 700 raketa në Ukrainë

Ushtria ruse ka hedhur rreth 4 700 raketa në objektivat ukrainase, që nga fillimi i pushtimit në shkurt, tha presidenti Volodymyr Zelensky. "Qindra qytete tona janë djegur praktikisht, mijëra njerëz janë vrarë, qindra mijëra janë deportuar në Rusi", tha ai në një video-mesazh drejtuar Organizatës Ndërkombëtare të Vendeve Frëngjishtfolëse (OIF). Sidomos muajin e fundit, Rusia



ka nisur një valë të re sulmesh ruse ndaj infrastrukturës kritike dhe janë rritur shqetësimet për furnizimin me energji elektrike të Ukrainës. Në të kaluarën, kur Rusia ka pësuar humbje në terren, ajo ka sulmuar përmes ajrit.

Javën e kaluar Moska ka tërhequr trupat e saj nga qyteti jugor Herson - një nga sukseset më të mëdha të Ukrainës në luftën e saj kundër pushtimit rus.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt.

Presidenti rus Vladimir Putin e konsideron luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Tokayev rizgjedhet president i Kazakistanit

ASTANA, 21 NËNTOR - Kassym-Jomart Tokayev është rizgjedhur president i Kazakistanit, shtetit më të madh të Azisë Qendrore. 69-vjeçari, i cili erdhi në pushtet në vitin 2019, mori 81.31 për qind të votave.

Rezultati ishte i pritshëm, pasi pesë kundërshtarët e Tokayevit ishin pak të njohur për

publikun. Asnjëri prej tyre nuk shënoi mbështetje dyshifrore në votim, ndërsa 5.8 për qind e votuesve votuan kundër të gjithë kandidatëve.

Komisioni zgjedhor tha se në zgjedhjet e së dielës kanë marrë pjesë rreth 70 për qind e qytetarëve, prej 12 milionë votuesve me të drejtë vote.

"Njerëzit kanë shprehur qartë besimin e tyre tek unë dhe ne duhet ta arsyetojmë atë", ka thënë Tokayev pas shpalljes së rezultateve.

Kazakistanit u zhyt në kaos gjatë protestave në janar të këtij viti, prej të cilave mbetën të vdekur 238 persona.

Tokayev, i cili drejtonte vendin

edhe në atë kohë, shtypi me dhunë këto protesta.

Ai e kishte përshkruar dhunën vdekjeprurëse të janarit si tentim për puç.

Protestat e nxitura nga rritja e çmimeve të naftës ishin shndërruar në trazirat më të këqija që ka parë ky shtet në 30 vjet të pavarësisë.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Qerim Qerimi zgjedhet rektor i Universitetit të Prishtinës

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Qerim Qerimi është zgjedhur rektor i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Me 6 vota për, Qerimi është votuar për ta udhëhequr UP-në gjatë mandatit nga nëntori i vitit 2022 deri në shtator të vitit 2024.

Në garën për të parin e UP-së kanë qenë gjashtë kandidatë: Ilir Tolaj, But Deda, Sefer Avdijaj, Ermir Rogova, Qerim Qerimi. Procesi i intervistimit të kandidatëve është ndarë në dy pjesë, në 20 minutat e parë kandidatët kanë

prezantuar programin e tyre, ndërsa në 20 minutat e tjera u janë përgjigjur pyetjeve të anëtarëve të Këshillit Drejtues (KD) të UP-së. Votimi për rektor është realizuar përmes votimit të fshehtë.



ASK-ja: Një qytetar i Kosovës 'prodhon' 0.75 kilogram bërlllok në ditë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës së Mbeturinave Komunale (AMK) për vitin 2021, ku theksohet se sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara nga kompanitë rajonale të mbeturinave dhe operatorët ekonomikë privatë, të

cilat merren me menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë për vitin 2021, ishte 485 mijë ton. Të dhënat e vitit 2021 tregojnë se mesatarja e mbeturinave komunale të grumbulluara në Kosovë ishte 273 kg për banor në vit, ndërsa mesatarja e mbeturinave të grumbulluara për banor në ditë ishte 0.75 kg. "Në Prishtinë dhe rajonin e saj, grumbullimi i

mbeturinave komunale për ditë ishte 0.84 kg/banor/ditë, ndërsa në rajonet e tjera të Kosovës sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara për ditë/për banor ishte 0.71 kg", thuhet në njoftimin e ASK-së.

Më tej theksohet se nga të dhënat e mbeturinave komunale të grumbulluara sipas rajoneve për vitin 2021, vërehet se sasia më e madhe e

mbeturinave të grumbulluara ishte në rajonin e Prishtinës me 151 mijë ton në vit, ose 305 kg për banor në vit. "Ndërsa sasia më e vogël e mbeturinave të grumbulluara ishte në rajonin e Ferizajt, me 37 mijë ton në vit, ose 202 kg për banor në vit. Gjithsej, sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara për vitin 2021 ka rritje për 6.4 % krahasuar me vitin 2020.

Gjithsej, sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara për vitin 2021 në Prishtinë dhe rajonin e saj ka rritje për 6.3 % krahasuar me vitin 2020", është theksuar në njoftimin e ASK-së. Po në këtë raport thuhet se gjithsej sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara për vitin 2021 në rajonet e tjera ka rritje për 6.4 % krahasuar me vitin 2020.

Ngrihet aktakuzë ndaj shtatë personave për veprën penale të krimit të organizuar

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka njoftuar se ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në Departamentin Special kundër të pandehurve me inicialet F.U., A.R., F.M., E.M., A.M., E.D. dhe M.V., lidhur me rastin "Mulliri" për kryerjen e veprave penale: "Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar" nga neni 277, paragrafi 1 të KPRK-së lidhur me veprat

penale "Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge", nga neni 267, paragrafi 1 i KPRK-së dhe veprën penale "Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit", nga neni 272, paragrafi 1 i KPRK-së. Prokuroria Speciale konsideron se ka prova të mjaftueshme që e vërtetojnë se të pandehurit kanë vepruar si grup i organizuar dhe i

strukturuar me hierarki në grup dhe me role të përcaktuara dhe se gjatë hetimeve janë siguruar dhe sekuestruar prova relevante juridike që dëshmojnë dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit i kanë kryer veprat penale me qëllim të përfitimit material të kundërligjshëm, duke bërë kultivimin e bimës narkotike me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ku të pandehurit janë arrestuar në vendin e ngjarjes.





ME NDËRMJETËSIMIN E JOSEP BORRELLIT, ALBIN KURTI DHE ALEKSANDËR VUÇIQ U TAKUAN NË BRUKSEL

S'ka marrëveshje për targat

Borrelli: Kurti nuk e pranoi propozimin tonë për targat, Vuçiqi po. Bëj thirrje që ky propozim të zbatohet

Ka përfunduar pa marrëveshje takimi në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili është ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian (BE). Ndërmjetësuesi i këtij takimi, Josep Borrell, ka thënë se Kurti nuk e ka pranuar propozimin e BE-së për targat, ndërsa Vuçiqi është pajtuar me këtë propozim. “Për hir të transparencës, ne parashtruan një propozim që mund ta shmangte këtë situatë të rrezikshme. Presidenti Vuçiq e pranoi por, për fat të keq, kryeministri Kurti nuk e pranoi” ka deklaruar Borrelli, duke i bërë thirrje Kosovës që ta pranojë propozimin e BE-së për targat. Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka akuzuar Borrellin për heqjen dorë nga marrëveshja e madhe

paligjshme për serbët e Kosovës që nga paslufta më 1999, e kundërshton këtë plan, duke insistuar në targa neutrale ndaj statusit të Kosovës. Si pasojë e tensioneve të ngritura, serbët e veriut të Kosovës - ku qarkullojnë kryesisht makinat me targa të paligjshme - kanë dhënë dorëheqje nga institucionet e Kosovës.

çështje të targave dhe nuk diskutojmë për normalizim”, ka thënë Kurti para gazetarëve. Sa i përket çështjes se Serbia ta pushojë emetimin e targave, Kurti ka thënë se “kjo për neve nuk është e pranueshme nëse nuk shoqërohet edhe me atë për të cilën kemi ftuar për normalizim të plotë të marrëdhënieve”. “Me keqardhje mund të them që ndërmjetësit, në këtë rast Borrelli, hoqi dorë nga afati i marsit të vitit 2023 dhe nga propozimi i BE-së për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Po them me keqardhje sepse vetë e kanë propozuar marsin e vitit 2023 dhe në anën tjetër propozimi është i BE-së. Kur u takuam në Paris në Forumin për Paqe, Borrelli tha se propozimi nuk është franko-gjerman, por i BE-së dhe i mbështetur nga Franca dhe Gjermania. Sot ai hoqi dorë nga propozimi i BE-së për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Unë jam i gatshëm të vijë këtu të zhvillojë takime gjithmonë me strukturën dhe rendin e njëjtë. Shpresoj që BE-ja t'i rrijë prapa propozimit të vet për normalizimin e marrëdhënieve të Kosovës dhe Serbisë”, ka thënë Kurti.

**EPOKA
ERE**

Lirim GEÇI

BRUKSEL, 21 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, janë takuar të hënë në Bruksel, por pa ndonjë rezultat. Ata nuk janë pajtuar për arritjen e një marrëveshjeje për targat. Pas takimit disa orësh, shefi i politikës së jashtme të Bashkimit Evropian (BE), Josep Borrell, i cili ka ndërmjetësuar takimin Kurti - Vuçiq, ka thënë se kryeministri i Kosovës nuk e ka pranuar propozimin e BE-së për targat. “Pas shumë orë diskutimesh, dy palët nuk u pajtuan për zgjidhjen sot (e hënë). Për hir të transparencës, ne parashtruan një propozim që mund ta shmangte këtë situatë të rrezikshme. Presidenti Vuçiq e

pranoi por, për fat të keq, kryeministri Kurti nuk e pranoi”, ka thënë Borrelli në një konferencë për gazetarë. Edhe pse nuk ka marrëveshje, Borrelli ka kërkuar nga Kosova që menjëherë “t'i pezullojë fazat e mëtejshme” të planit për rirregjistrimin e makinave në veri të Kosovës, ndërsa nga Serbia “të pezullojë lëshimin e targave” të reja, të tilla si KM, që në Kosovë konsiderohen të paligjshme. “Unë u kërkoj të dyja palëve t'i zbatojnë këto dy kërkesa. Kjo do të ofrojë hapësirë dhe kohë për to që të kërkojnë zgjidhje të qëndrueshme për çështjen e targave”, është shprehur Borrelli. Ai ka thënë se “do t'i informojë shtetet anëtare të BE-së, partnerët, për sjelljen e palëve dhe mosrespektimin e detyrimit ligjor ndërkombëtar”. “Kjo vlen

veçanërisht për Kosovën”, ka thënë Borrelli. Edhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka njoftuar se “nuk kemi arritur absolutisht asnjë marrëveshje”. Por, sipas tij, është arritur njëfarë pajtimi për një gjë. “Do t'i dëgjojmë këshillat dhe kërkesat e përfaqësuesit të lartë (evropian), Borrell. Ai ka kërkuar që ata (zyrtarët kosovarë) të mos shqiptojnë gjopa, që ne mos të lëshojmë targa të reja KM – për ç'gjë ne kemi thënë se është në rregull. Ne do ta respektojmë këtë. Do të shohim se çfarë do të bëjë pala tjetër”, ka thënë presidenti serb. Qeveria e Kosovës ka nisur më 1 nëntor zbatimin e planit të saj për rirregjistrimin e makinave me targa të paligjshme serbe në targa RKS, apo Republika e Kosovës. Serbia, e cila lëshon targa të

Kurti akuzon Borellin se hoqi dorë nga marrëveshja e madhe

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka folur për media pas takimit me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, me ndërmjetësimin e shefit të Bashkimit Evropian (BE) për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell. Kurti ka thënë se propozimi i BE-së që Kosova mos të shqiptojë gjopa dhe Serbia mos të lëshojë targa KM është i papranueshëm për të. Ai ka thënë se shpreson se BE-ja do ta gjejë forcën që t'i rrijë prapa propozimit të saj për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Nuk mund të shndërrohemi me liderë shtetërorë që merremi me

Ambasadori britanik, i zhgënjyer për mosarritjen e marrëveshjes në Bruksel



PRISHTINË, 21 NËNTOR - Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Nicholas Abbott, është i zhgënjyer me mosarritjen e marrëveshjes për tarrgat në Bruksel mes Kosovës

dhe Serbisë.

Abbott tha se situata aktuale paraqet një rrezik për sigurinë. Ai tha se palët duhet të shmangin veprime që çojnë në tensionimin e situatës. “Është

zhgënjyese që sot nuk është arritur asnjë marrëveshje. Situata aktuale paraqet rrezik për sigurinë dhe jetesën e njerëzve të zakonshëm në Kosovë dhe largon vëmendjen

nga misioni i qeverisë për të përmirësuar jetën e tyre. Të gjitha palët duhet të shmangin veprimet që mund të çojnë në një përshkallëzim të tensioneve ose të shkaktojnë kërcënime për

sigurinë. Nevoja urgjente është të bëhet përparim në një marrëveshje normalizimi që do t'i bënte të panevojshme mosmarrëveshjet për çështje të tilla si tarrgat”, tha Abbot.

Kuvendi nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Federatën Pan-Shqiptare “Vatra”



EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Kuvendi i Kosovës ka nënshkruar të hënën memorandum mirëkuptimi me Federatën Pan-Shqiptare “Vatra” për bashkëpunim për krijimin dhe hartimin e një strategjie mbarrëkombe. Memorandumi i mirëkuptimit u nënshkrua nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca dhe kryetari i Federatës Pan-Shqiptare “Vatra”, Elmi Berisha. Me këtë rast,

Konjufca ka thënë se Federata Pan-Shqiptare “Vatra” ka lënë gjurmë në shtetndërtimin e Kosovës, duke dhënë kontribut të vazhdueshëm për pavarësinë e Kosovës dhe për gjithçka që ka qenë e mirë dhe e nevojshme për bërjen e shtetit.

Konjufca ka theksuar se dyert e Kuvendit gjithnjë do të jenë të hapura për këtë federatë dhe inkurajon që të vazhdojë njëjtë me punën e saj sikur deri më tani. Ndërsa kryetari i Federatës “Vatra”, Elmi Berisha, ka thënë se tash

është koha më e mirë që të kanalizohen energjitë tona, intelektuale dhe lobuese, në mënyrë që të formalizohet njohja reciproke me Serbinë. Sipas tij, kjo energji duhet të përdoret nga shqiptarët me të gjitha institucionet e tjera në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Përmes këtij memorandum Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Federata “Vatra” zotohen se do të bashkëpunojnë në aktivitetet, duke pasur parasysh pikat e interesit të përbashkët.

Kuvendi do t'i mbështesë aktivitetet e kësaj Federate dhe promovimin e tyre, ndërsa Federata “Vatra”, sipas nevojës, do të ofrojë mbështetje për Ministrinë e Jashtme dhe të Diasporës, me qëllim rakordimin e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës me Departamentin Amerikan të Shtetit dhe lobimit në favor të Kosovës.

Sipas memorandumit, po ashtu Federata Pan-Shqiptare “Vatra” do të shërbejë si promovuese dhe

garantuese e hapësirave dhe mundësive që ofron ekonomia dhe tregu i Republikës së Kosovës për komunitetet shqiptaro-amerikane të biznesit në Amerikë, ndërsa Kuvendi i Kosovës dakordohet të bashkëpunojë në fushën e sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, ekonomisë dhe biznesit, si dhe në fusha të tjera të interesit të përbashkët, gjithmonë duke pasur primar interesat kombëtare dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me politikën e ShBA-së dhe BE-së.

Propozimi franko-gjerman në dy faza, mashtrim ordiner!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Kujt t'i besohet: Qytetarët e Kosovës, në mungesë të informatave zyrtare, po bombardohen me propozime të ndryshme që lëshohen si fluska sapuni për t'i matur reagimet e opinionit. Pas kësaj, nëse reagimi është më kundërshtues, shtetet që nuk po ofrojnë asnjë zgjidhje, por futjen e problemit në turshi për një afat, fillimisht 10 vjet, po distancohen nga propozimi duke thënë se nuk është propozim i tyre për të vazhduar pastaj me propozime të tjera. Në këtë mënyrë çështjen e Kosovës e kanë shndërruar në një striptiz shou, në afate të caktuara e heqin ndonjë pikë të propozimit duke e lënë për fund lakuriqësinë që në asnjë mënyrë nuk do të jetë i mirë për Kosovën duke e futur statusin e saj në një çark të mbyllur. Gjermania që ka investuar miliarda e miliarda euro në ekonominë e Serbisë, që këto investime kanë regjeneruar midis 70 000 - 100 000 vende pune në Serbi dhe që këmbimi tregtar matet me miliarda euro gjatë një viti, në ndërkohë që Kosovën e trajton si rast social, vështirë të jetë një propozues i besueshëm dhe i drejtë, kurse Franca tradicionalisht ka menduar dhe vepruar serbisht.

Albin Kurti, një kryeministër me 51 % përkrahje, problemin kryesor e ka pasur si të sille me karshillëk me Edi Ramën dhe, në këtë kontekst, duke e kundërshtuar Ballkanin e Hapur po del të jetë fanatikisht i dhënë pas Procesit të Berlinit që vetëm me ambalazhim dallon nga Ballkani i Hapur. Kape njërën, mëshoji tjetrës. Që nga koha e kancelares Merkel, Kosova asnjëherë nuk ia ka parë hairin Gjermanisë, madje kancelarja, tash e pensionuar, as që takohej me udhëheqësit kosovarë. Takohej me ushtarët gjermanë të KFOR-it për të vazhduar për Beograd në përfaqim politik dhe ekonomik të Aleksandar Vuçiqit. Loja e Albinit në pokerin ballkanik vetëm me një kartë, atë të Sholcit, është humbje e pashmangshme aq më parë që asnjëherë nuk ka pasur ekip më jodashamirës ndaj Kosovës se që ka tani, mashtruesit ordinerë, Borrell dhe Lajçak, që po e

zbatojnë një propozim franko-gjermano-serb që ka për qëllim shmangien, me çdo kusht njohjen reciproke e që është parakushti dhe kushti kryesor për një marrëveshje të qëndrueshme si dhe ndarjen pakthyeshmë të dhenve dhe dhive me Serbinë.

Një krahasim midis suprimimit të autonomisë dhe mohimit të njohjes reciproke: Në fund të viteve '80 Kosova e humbi një autonomi që e kishte dhe që në një mënyrë e përfaqëonte me statusin e republikave tjera. Ish-Jugosllavia hyri në rrugën e shkatërrimit të pashmangshëm për faktin se shqiptarët, ajo masa kritike dhe atdhetare nuk pajtohej me këtë autonomi kurse Sllovenia dhe Kroacia haptasi donin të pavarësoheshin gjë që edhe e bënë. Kosova mbeti në mëshirën e Serbisë dhe pjesës serbe të ish-Jugosllavisë dhe bashkëpunëtorëve të saj, rrogëtarë të bindur dhe të devotshëm që flisnin shqip e që ishin pjesë e strukturave komuniste të asaj kohe, profesorë në Universitetin e Prishtinës, gazetarë dhe diplomatë sikur që zagaret e sigurimit serb që, për fat të keq flisnin shqip, shquheshin si dhunuesit më të mëdhenj të të gjithë atyre që për synim e kishin lirinë, çlirimin dhe bashkimin e trojeve shqiptare. Marrjes së autonomisë i parapriu një fushatë "vetëdijesimi" të intelektualëve shqiptarë, të disa gazetarëve dhe filozofëve, politikanëve lokalë, atyre që lehnin në diplomaci në gjuhën serbe e që, kinse ishin shqiptarë se: "me ndryshimet kushtetuese Kosova, jo që nuk humbë asgjë por vetëm sa përfiton...". Ky ekip i horrave shëtitës shkonin nga vendi në vend për të bindur që të mos kundërshtohen këto ndryshime kushtetuese sikur edhe për të folur kundër nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar që ka për synim shkatërrimin e Jugosllavisë, si vend ku jetonin të vëllazëruar dhe të bashkuar kombet dhe kombësitë jugosllave. Ky ekip i horrave shëtitës kërkonin që pamëshirshëm të dënohen këta rrënues të socializmit vetëqeverisës në kohën kur Kuptimi dhe Përmbajtja e Luftës për Liri të shqiptarëve, Bacë Adem Demaçi kishte hyrë në vitin e 29 mbajtjes së dënimit në llogoret e përqendrimit të ish-Jugosllavisë, në kohën kur në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe viset ku jetonin dhe punonin shqiptarët, qindra dhe mijëra shqiptarë dënoheshin me dënime të larta, torturoheshin

dhe vriteshin në burgjet jugosllave. Po në këtë kohë dhjetëra e dhjetëra ushtarë shqiptarë që dërgoheshin dhunshëm në ushtrinë jugosllave ktheheshin të vrarë në arkivole të mbyllura hermetikisht sikur që dhjetëra e dhjetëra të tjerë dënoheshin nga gjykatat ushtarake me dënime shumë të larta në procese të montuara politike. Në atë kohë nuk kishte stacion policor, qendër e paraburgimit apo burg në Jugosllavi e që shumica e të burgosurve të mos ishin shqiptarë. Ushtria e Lavdishme Çlirimtare e Kosovës, me një luftë të jashtëzakonshme, e përkrahur edhe nga ndërkombëtarët e çliroi Kosovën kurse në vitin 2008 u shpallë pavarësia e Kosovës. Qysh në Rambuje, francezët vendosën apo e imponuan ndarjen e Mitrovicës duke vendosur një postbllok mbi urën e lumit Ibër kurse në shkurt të vitit 2000, Rojat e Urës dhe paramilitarët tjerë, të papenguar nga xhandarmeria franceze vranë 11 shqiptarë dhe dhunshëm u dëbuan mbi 13.000 shqiptarët të cilët kurrë nuk u lejuan të kthehen në pronat e tyre duke krijuar një situatë krejt tjetër etnike që sot po e përdorin, edhe serbët, edhe ndërkombëtarët si shantazh ndaj Kosovës. Kur u shpallë pavarësia e Kosovës të gjithë policet serbë e lëshuan vendin e punës për t'u kthyer pas një viti sikur që shumica e Rojave të Urës dhe paramilitarët u "integruan" në ministri të ndryshme ku merrnin rroga pa e bërë edhe as një minutë punë të vetme. Serbët shantazhin përmes protestave dhe bllokimit të rrugëve e shndërruan në mënyrë veprimi me qëllim të realizimit të projekteve politike të Serbisë. Pa vendimit të Qeverisë së Kosovës për zëvendësim të targave ilegale, vendim krejtësisht në përputhje me ligjin, serbët i lëshuan të gjitha institucionet e që ky veprim ishte mirë i planifikuar nga Serbia. Tash, për kthim në institucione kërkohet anulimin e vendimit për targa dhe formimin e Zajebnicës. Për këtë e kanë përkrahjen e plotë të ndërkombëtarëve dhe presioni mbi Qeverinë e Kosovës po rritet shumë e më shumë. A do t'i bëjë ballë Qeveria e Kosovës këtij presioni? Me gjasë dhe me siguri të madhe e them se jo. Vetëm do të kërkohet një dalje arsyetuese për Qeverinë e Kosovës që të mos konsiderohet si humbëse absolute. Dhe, sigurisht se do të gjendet kjo dalje. Për targa Qeveria e Kosovës do të thirret në kërkesën ultimative të ShBA-së dhe BE-së për një shtyrje të pakushtëzuar të ndërrimit të

targave ilegale sikur që mund të vazhdojë duke mos shqiptuar gjoba. Realisht, për këtë e ka edhe përkrahjen e opozitës në Kosovë e cila është shumë këmbëngulëse që të përfilllet kërkesa e ndërkombëtarëve prandaj qeveria del nga kjo situatë e pacenuar kurse Kurti del edhe më i fuqishëm politikisht. Nëse shkohet sipas këtij skenari. Kundërshtarët e shtyrjes së afatit për ndërrim të targave ilegale e që thirren në shtrirje të sovranitetit, nuk janë në gjendje ta shtrijnë as edhe një sofrabaz si duhet e lëre më sovranitetit! Këta janë të pafuqishëm ta bëjnë këtë kurse nuk janë në gjendje ta sakrifikojnë as edhe një makiato për shtrirje të sovranitetit. Targat janë problem minor krahasuar me Zajebnicën dhe, jam shumë i sigurt se edhe nëse shtyhet afati për targat e ai sigurisht do të shtyhet, problemi nuk zgjidhet, vetëm peshatet për një kohë. Lëshimi ndaj kërkesave të Serbisë dhe atyre që e lëshuan punën krijon, veç ka krijuar një precedent të rrezikshëm sepse çdo kërkesë mund dhe do të kushtëzohet me largim nga puna, bllokim të rrugëve dhe të institucioneve. Kush e gjen zgjidhjen në këtë rast, vërtet mund të llogaritet gjeni.

Duke pritur Godon - njohjen reciproke: Propozimi franko-gjerman nuk zgjidhë asgjë vetëm sa e përforcon një çark të mbyllur duke premtuar një dalje eventuale pas 10 vjetësh nëse në ndërkohë nuk do të ketë ndryshime që këtë çështje e lënë krejtësisht në harresë. Sikur që ishte krijuar një ekip hortrash që arsyetonin se: "me ndryshimet kushtetuese Kosova jo që nuk humbë asgjë për se vetëm përfiton...", edhe për propozimin franko-gjerman mbetjet politike dhe ideologjike të paraardhësve të tyre arsyetojnë se: "në propozimin franko-gjerman vërtet nuk thuhet shprehimisht se do të ketë njohje reciproke mirëpo nënkuptohet nga teksti se ka njohje faktike por jo edhe juridike ..." Çfarë demagogë dhe të pandershëm! Në propozimin franko-gjerman, nëse i referohemi atyre që kanë qarkulluar në media, njohja reciproke jo që nuk është në qendër por nuk është as në bisht! Vetëm duan të fitojnë kohë duke krijuar një alibi që ky propozim të përkrahjet për një afat 10-vjeçar e që, pastaj, Serbia ndoshta do ta pranojë pavarësinë e Kosovës. Po nuk e pranon tash, pas 10 vjetëve as Serbia e askush nuk do ta pranojë këtë që po premtohet nga ndërkombëtarët e që, me aq zell

po e përkrahin mashtruesit ordinerë, mercenarë të përjetshëm, tash të shndërruar në multimilionerë! Që nga përfundimi i luftës, Serbia është imponuar si hisedare për çështje të brendshme të Kosovës dhe vetëm njohja reciproke tash, sepse pas 10 vjetëve do ta ketë fatin e Godos së Samuel Beketit, do të ishte zgjidhje e qëndrueshme dhe stabilizuese. Nëse lëshohet ky rast, asnjë problem nuk do të zgjidhet por vetëm do të konservohet duke e hapur konservën kur Serbia do të ketë interes. Opozita dhe Qytetarët e Kosovës duhet ta përkrahin Qeverinë e Kosovës për nënshkrim të një marrëveshje vetëm nëse juridikisht përfshihet njohja reciproke dhe çdo propozim tjetër duhet të refuzohet. Nëse njohja reciproke do të shtyhet për 10 vjet, për fillim, atëherë pavarësia e Kosovës do të ketë përmbajtjen e një shkrimi që e pata shkruar para vitit 2008 me titull "Prej Horgoshit, në Dragash, pavarësia daj shta dash..." ose: "Prej Horgoshit (në Vojvodinë) në Dragash (Kosovë), pavarësia, jep sa të doni...".

Nenad Çanaku dhe Vojislav Shesheli: Nenad Çanaku ishte deputet në Kuvendin e Serbisë kurse Vojislav Shesheli, përveç si kriminel luftime që e kishte profesionin kryesor, ishte bartës i shumë posteve në Serbi. Çanaku, që njihet si liberal dhe me qasje pozitive (ndonëse kishte propozuar që me ushtri të zhbëhej pavarësia e Kosovës) për Kosovën, në një intervistë tha se Vojislav Shesheli, në operacionin "Llazar" e paska joshur dhe bërë Albin Kurtin bashkëpunëtor të Serbisë gjatë kohës sa ishte në Burgun e Nishit. Unë kam menduar se Albini tërë kohën ka qenë në Burgun e Pozharevcit. Nuk më bëri aspak përshtypje Çanaku sa më bënë përshtypje reagimet që donin vërtetë që Albini të jetë spiun i Serbisë e që për atë kohë, sipas bindjes sime, më parë do të zhdukej bota, se që Albini të bëhej spiun i Serbisë. E pamundur krejtësisht. Albini në atë kohë ishte trim, i vendosur dhe atdhetar dhe nuk e bënte asnjë kompromis në dëm të këtyre cilësimeve. Pastaj, vet Çanaku tha se kjo deklaratë e tij ishte thjeshtë sarkazëm, përkthyer në shqip, paska luajtur koçë! Po një çështje e kam shumë të qartë, me sarkazëm apo pa te, Nenad Çanak e ka dëmtuar panevojshëm Albin Kurtin dhe, gjithashtu jam i sigurt se prapa kësaj sarkazme/luajtje koçesh është një qëllim! Aspak i mirë!

Osmani: Ritchie Torres, një zë i fuqishëm i Kosovës në Kongresin amerikan

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur të hënën në takim kongresistin amerikan Ritchie Torres, njëherësh bashkëkryesues i Grupit për Çështjet Shqiptare në Kongresin Amerikan, të cilin e ka falënderuar për punën e tij të jashtëzakonshme në mbështetje të Republikës së Kosovës si dhe e ka njoftuar për

zhvillimet në Kosovë dhe situatën aktuale të sigurisë. Në takim me kongresistin Torres, Osmani vuri theksin në forcimin e partneritetit strategjik me ShBA-në si dhe angazhimin e tij për mbështetjen e mëtejme të Kosovës. Në këtë drejtim presidentja Osmani theksoi se kongresisti Torres po e vazhdon trashëgiminë

historike të kongresistit Eliot Engel, duke qenë zë i fuqishëm i Kosovës në Kongresin Amerikan.

Kongresisti Torres ka theksuar se Kosova është mike dhe aleate e palëkundur e Shteteve të Bashkuara dhe se do të punojë afër me administratën amerikane për ta vazhduar mbështetjen për Republikën e Kosovës.



Shtëpi, biznese e rrugë të dëmtuara nga vërshimet



Prishtinë, 21 nëntor - Përmbytjet që shkaktuan shirat e furishëm të dielën dëmtuan shtëpi, biznese, kultura bujqësore dhe rrugë në disa komuna të Kosovës.

Istogu, Peja, Vushtrria dhe Juniku janë ndër më të prekurat dhe zyrtarë të institucioneve atje thonë se kanë nisur tashmë të bëjnë vlerësimin dhe sanimin e dëmeve. Nga kompania e ujësjellësit rajonal "Prishtina" thonë se përmbytjet kanë turbulluar ujin në disa pjesë, duke çuar në reduktime. "Me qëllim që ta ruajmë kualitetin e ujit për pije, jemi të detyruar ta ndërpresim furnizimin me ujë të pijshëm në Fushë-Kosovë, në lagjen Kalabria në Prishtinë, në Drenas dhe në Obiliq", thotë për "Radion Evropa e Lirë" Arjeta Mjeku, zëdhënëse në këtë kompani. Sipas saj, furnizimi i rregullt do të rikthehet "në momentin që garantohej cilësia e duhur e ujit".

Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Istog,

Abedin Kabashi, thotë se situata në këtë komunë është më e qetë, por vazhdon të jetë e rëndë në disa zona. "Deri në orët e vona kemi qenë në terren, kemi pasur ndërhyrje në disa fshatra në luginën e Drinit, ku gjendja ka

qenë më e rënduar. Kemi bërë intervenime për ta tejkaluar rrezikun e dëmtimeve më të mëdha në ekonomi familjare", thotë Kabashi për "Radion Evropa e Lirë". Sipas tij, në dy shkolla dhe në një çerdhe të Istogut është



ndërprerë procesi mësimor, pasi rrugët që çojnë në këto institucione janë të pakalueshme për këmbësorë.

Tre lumenjtë e kësaj komune, ai i Istogut, Shushicë dhe Kujavç, dolën vende-vende nga shtrati. Për t'i shmangur situatat e tilla, Kabashi thotë se shtretërit e dëmtuar të këtyre lumenjve duhet të rregullohen.

Reshjet e shiut me intensitet dhe shtrirje të ndryshme territoriale kanë vazhduar edhe gjatë ditës së hënë nëpër disa pjesë të Kosovës, përfshirë: Gjakovën, Junikun, Deçanin, Pejën, Istogun, Klinën, Malishevën, Rahovecin etj.

Në Vushtri, komunë po ashtu e prekur nga vërshime, drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Maliq Ferizi, thotë se situata është vënë nën kontroll. "Jemi në terren, po vizitojmë banorët që janë prekur nga vërshimet dhe po bëjmë evidentime të dëmeve. Dëme të mëdha nuk ka. Bodrumet në disa shtëpi janë vërshuar. Shtabi

emergjent është në gjendje gatishmërie", thotë Ferizi për "Radion Evropa e Lirë".

Ndërsa Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e Kosovës njoftoi se është duke bërë hartat e rrezikshmërisë nga përmbytjet dhe hartimin e planeve për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet dhe thatësira, në mënyrë që, siç tha, në situata të tilla të jenë më të përgatitur.

Ministria u zotua se do t'i përmirësojë kapacitetet parandaluese dhe reaguese në situata të ngjashme. "Jemi të angazhuar që të marrim masa konkrete përmes investimeve në infrastrukturë", tha kjo ministri. Shirat e furishëm shkaktojnë shpesh vërshime në Kosovë. Vlerësohet se dëmtimi i shtretërve të lumenjve, si pasojë e nxjerrjeve të paligjshme të zhavorrit, kontribuon shumë në përmbytjen e zonave.

Të fundit të mëdha kanë qenë përmbytjet në korrik në disa komuna të Kosovës, përfshirë Vushtrrinë, Gjilanin, Prishtinën etj.

Reshjet e shiut rritën edhe nivelin e Lumit Erenik në Junik. Demokrat Ganijaj, drejtor për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim në këtë komunë, thotë se, përveç të tjerash, muret mbrojtëse të këtij lumi janë dëmtuar. "Kemi dëme në infrastrukturë, kemi dëme në Lumin Erenik, muret mbrojtëse të lumit janë dëmtuar si pasojë e vërshimeve, kemi një biznes që është përmbytur nga vërshimet", sqaron Ganijaj për "Radion Evropa e Lirë". Sipas tij, komuna, së shpejti do të themelojë një komision për evidentimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet.

Ekspertja e emergjencave shëndetësore nga Izraeli viziton ShSKUK-në

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Ekspertja e emergjencave shëndetësore nga Izraeli, dr. Odeda Benin Goren, dhe ambasadorja e Izraelit në Kosovë, Tamar Ziv, të hënën vizituan Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të

Kosovës.

Në takim me u.d. drejtoreshën e përgjithshme e ShSKUK-së, Pranvera Zejnullahu-Raçi, është biseduar në lidhje me funksionimin e shërbimeve emergjente në nivel të ShSKUK-së dhe për mundësitë e

bashkëpunimit dhe përkrahjes profesionale për këto shërbime. Delegacioni nga Izraeli do t'i vizitojë disa nga klinikat e QKUK-së dhe Spitalin e Përgjithshëm në Prizren për ta parë nga afër punën e këtyre institucioneve.



Javën e kaluar KEDS-i zuri 185 konsumatorë duke e vjedhur energjinë elektrike

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS) ka vazhduar aksionet për kontrollë rreth keqpërdorimeve të konsumatorëve të cilët dyshohet se kanë keqpërdorur energjinë elektrike. Sipas njoftimit, brenda një jave ekipet e KEDS-it kanë kryer 1 940 kontrolle të konsumatorëve të energjisë elektrike, ku 185 prej

tyre është vërtetuar se kanë qenë duke e anashkaluar matjen e saktë të energjisë elektrike. "Planet dhe aksionet për kontrolle të keqpërdorimeve të ekipeve të Departamentit të Humbjeve në KEDS vazhdojnë të implementohen në tërë Kosovën çdo ditë. Vetëm gjatë javës së kaluar në të gjitha distriktet dhe nëndistriktet janë kryer 1 940 kontrolle të

konsumatorëve të energjisë elektrike, për të cilët dyshohej se po keqpërdorin rrymën. Prej tyre 185 u vërtetua se po e anashkalonin matjen e saktë të energjisë elektrike. Keqpërdorimi i energjisë elektrike është i papranueshëm dhe i dënueshëm. Rastet e tilla ekipet e KEDS-it do t'i parashtrajnë për procedura të mëtutjeshme gjyqësore", ka njoftuar KEDS-i.



Vjedhja e rrymës mund t'u kushtojë konsumatorëve dhe buxhetit rreth 100 milionë euro



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka udhëhequr takimin për luftimin e vjedhjeve të energjisë elektrike, në të cilin kanë marrë pjesë ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, zëvendësministri i Drejtësisë, Blerim Sallahu, kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRë), Ymer Fejzullahu, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, Albert Zogaj,

përfaqësues të Zyrës së Prokurorit të Shtetit, Policisë së Kosovës si dhe kompanisë Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike në Kosovë sh.a. (KEDS). Ministria Rizvanolli ka thirrur këtë takim me qëllim të koordinimit ndërinstucional për shmangien e humbjeve komerciale në shpërndarje të energjisë elektrike apo vjedhjeve të energjisë elektrike. Sipas raportit vjetor të ZRRë-së, këto humbje në vitin 2021 kanë qenë 6.16 për qind apo 386 GWh.

Me çmimet e importit të energjisë elektrike që pritet të mbretërojnë gjatë muajve në vijim vazhdimi i një trendi të tillë të humbjeve komerciale mund t'i kushtojë vendit (konsumatorëve dhe buxhetit) 100 milionë euro gjatë sezonit të vjeshtës dhe dimrit. Ministria Rizvanolli u ka bërë thirrje të gjitha institucioneve përgjegjëse për siguri dhe sundim të ligjit, konform kompetencave të tyre ligjore, që duke pasur parasysh krizën energjetike në vend, ta trajtojnë parandalimin dhe luftimin e

vjedhjeve të energjisë elektrike, gjë që do të ndikonte drejtpërdrejt në sigurinë e përgjithshme dhe të qëndrueshëm të furnizimit me energji në Kosovë. Gjatë takimit ministri Sveçla ka potencuar se luftimi i vjedhjeve të energjisë elektrike është temë jashtëzakonisht e rëndësishme pasi ngjarjet globale patjetër që ndikojnë në sigurinë energjetike dhe energjia në siguri të vendit. "Është jashtëzakonisht e rëndësishme të kemi stabilitet energjetik pasi është parakusht

për stabilitet të sigurisë kombëtare", ka potencuar ai. Këshilli Gjyqësor, Zyra e Prokurorit të Shtetit e Policia e Kosovës kanë shprehur gatishmëri të plotë për bashkëpunim që ta trajtojnë luftimin e vjedhjes së energjisë me prioritet të lartë. Pas takimit fillestar për bashkëpunim do të mbahen takime të radhës teknike për hartimin e planit të veprimit e për t'i identifikuar mënyrat specifike se si mund të luftohen vjedhjet e energjisë nga të gjitha institucionet relevante.

Filloi realizimi i projektit 'Krijimi i ambientit turistik në malet e Kabashit dhe të Korishës'

PRIZREN, 21 NËNTOR - Drejtorja e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik e komunës së Prizrenit, në kuadër të projekteve për zhvillimin e turizmit malor,

filloi të hënën realizimin e projektit 'Krijimi i ambientit turistik në malet e Kabashit dhe të Korishës', i cili destinacion është mjaft i vizituar nga turistët dhe

qytetarët e Kosovës. Ky investim, në këtë ambient turistik, do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e turizmit të komunës së Prizrenit.



Kujtime për Kongresin e Manastirit: Si do ta bajmë Shqypninë kur na nuk duem me u marrë vesht ndërmjet vedit



Nga: Gjergj FISHTA

Ishim nga të gjitha skajet e Shqipnisë dhe të kolonive shqiptare ndër dhena të hueja. U treguam me të vërtet shqiptar sepse kurnjani nuk donte me i lëshue asnji fije penit nga mendimi i vet atij tjetrit. Kongresi duhej të shpërndahej pa marrë kurnji vendim.

– U tërbova nga inati, U çova në kambë e u fola: – O burra shqyptarë, po a me të vërtetë do t'i lamë marre vedit para të gjithë botës?

– Po a mendoni ndopak se çka do t'u thomi shqyptarëve kur të na pvesin se çka keni ba ju dijetarët atje në Manastir?

– Çka do t'u thomi na njerzve të pashkollë që nuk dinjë as me shkruie as me këndue? ... Na jemi që mendojmë me ba Shqypninë

e si do ta bajmë atë kur na nuk duem me u marrë vesht ndërmjet vedit se si duhet me u shkruie germa A e ajo!

– Burra po u flas me zemër në dorë se asht marre e turp e faqe e zezë me i lanë marre vedit para popullit shqyptar e para tanë botës, që pret dishka prej nesh e na të kthejmë pa kurrëgjia në dorë ndër shpija tona.

– Po ulnju burra, ulnju sheshit e pse të kalojmë edhe një ditë ma shumë në këtë vend, mos ta lamë duerbosh popullin që na pret!...

– Aferim! P. Gjergj! ... Aferim të kjoftë, bërtiti më të madhë një hoxhë me mjekër. Ai u çue në kambë e erdh drejt te un, e më puthi në ballë e më tha: – Kështu flet shqiptari që e di që asht shqiptar! ...

Ulnju burra, – u tha, – ulnju këtu në shesh të zgjedhim një komisjon e në krye të vemë

Pader Gjergj Fishten e vetëm komisjoni do të caktojë se shka duhet të bajmë sot – për të mirën e popullit shqiptar neser...

Fjala e tij u ndigjue me duartrokitje e më caktuen Kryetar të Komisionit të Kongresit të Manastirit, i cili do të delte bosh sikur mos të ishte tregue toleranca e eme që të pranojshm dy alfabetet njiherit, atë të Stambollit që kërkonte Mit'hat Frashëri dhe këtë që u vendos.

Kjo sjellje e eme në Kongres të Manastirit më ka kushtue mjaft shtrejt në jëtë sepse Abat Doçi, të cilin un e përfaqsova në atë Kongres, m'u idhnue. E, kur u ktheva më tha: Pater Gjergj, un të kam dijtë si nieri që nuk ban kompromis në jetë! ...

Por Shqypnija nuk mund të bahej ndrysh...

Mehmet Elezi: Gjuha shqipe rrezikon të ketë fatin e latinishtes

“Standardi i gjuhës shqipe duhet të reformohet pa prekur bazën e toskërishtes nga dijetarë të mençur që iu rreh zemra shqip”, kështu deklaroi në një intervistën për Merita Haklajn, gjuhëtari Mehmet Elezi, pasi në të kundërt gjuha shqipe është e rrezikuar.

“Nuk jam kurrsesi për përmbysjen. Ky standard duhet të mbetet, por duhet të reformohet. Të ruhet baza toskërishte. Të mos preket, kjo është themelore. Ky standard të hapet të përpunohen rregulla që të hapet në mënyrë shkencore dhe jo kakofoni. Në përputhje me rregullat gjuhësore. Kjo është e domosdoshme, se sot ka ndodhur ndryshime marramendëse në të gjithë rajonin”,

Duke theksuar domosdoshmërinë e reformimit të gjuhës shqipe, Elezi sjell në vëmendje historinë e dhimbshme të gjuhës latine, ku ajo zyrtare u shkëput nga ajo e folura.

“Ka një përvojë historike të dhimbshme me latinishten, nëse e shohim si pasqyrë të mundshme të zhvillimeve në vendin tonë. Latinishtja zyrtare u shkëput nga ajo e folura popullore dhe kjo mbeti gjuhë e vdekur me të vdekurit dhe kjo është vetëm në libra, ndërsa nga latinishtja popullore u krijuan disa gjuhë, si italishtja, frëngjishtja, spanjishtja, rumanishtja. Është rreziku në një të ardhme, jo të shkurtër, që të krijohet shkëputje dhe standardi të mbetet një gjuhë e ftohtë, e largët dhe kombi shqiptar të

vuajë një përçarje gjuhësore, rrëmujë në mungesë të një standardi të mirëfilltë”.

Një tezë të përafërt për reformimin e gjuhës shqipe, por edhe për shkëputjen e mundshme të saj sikurse asaj latine, kishte edhe Çabej, i cili theksonte domosdoshmërinë e një gjuhe shqipe për të gjitha trevat shqipfolëse.

“Çabej thoshte na duhet një gjuhë shqipe për katër milionë shqiptarë. Pra, të hapet që të gjithë shqiptarë të gjejnë veten dhe të forcojë imunitetin e brendshëm. Është globalizmi. Erërat e globalizimit të japin të ftohurë brinjë më brinjë dhe i pari ftohet ai me imunitet të dobët. Gjuhë më e vogël se është më pak e lëvruar përballë botës. Po të shohësh sot futen fjalë anglisht pa nevojë. Një reformim i mençur nga dijetarë që u rreh zemra shqip. Një tezë e përafërt e Çabejt thotë që duhet të ruajmë gjuhën shqipe që të mos bëhet gjuhë e pasme e prapambetur, se sot kemi dy gjuhë shqipe. Këtë e thotë më 1967. Një është gjuha letrare dhe tjetra e popullit dhe nuk duhet të ndodhë kurrë kjo shkëputje dhe sot tendencat janë të pandalshme nëse nuk reformohet gjuha shqipe”.

Elezi bëri të ditur se Akademia e Shkencave e Kosovës është tërhequr nga hartimi i Fjalorit të përbashkët shqip, i njoftuar pak ditë më parë se do të ishte gati pas dy vitesh. Për Elezin kjo është e dëmshme dhe theksoi nevojën e gjetjes së mirëkuptimit për të punuar bashkarisht

“Akademia e Kosovës është tërhequr dhe ka mbetur një gjuhëtare në pension. Kjo është e dëmshme dhe është tërhequr se nuk kanë gjetur mirëkuptimin me akademinë këtu dhe kjo është shumë e dëmshme dhe që tani këtij fjalori nuk mund t'i besohet. Nëse do të punojnë bashkërisht të bashkohen dijetarë në mënyrë të barabartë me seriozitet, përndryshe gjuha shqipe është e rrezikuar. Në të ardhmen është rreziku nëse nuk reformohet standardi, pa prekur bazën toskërisht, mund të krijohet shkëputje mes standardit që përdoret në komunikimet zyrtare dhe gjuhës së përditshme dhe një pjesë të medias. Mund të ndodhë”.

Vështirësinë e kuptimit nga toskët të gegnishtes, Elezi e lidh me standardin, pasi para vitit 1944 dy dialektet po shkonin drejt shkrirjes, paskajorja dhe gegnishtja, sipas tij, kuptoheshin edhe në jug. Dhe, prandaj sugjeron hapje të standardit. Por, kjo për gjuhëtarin kërkon edhe shumë vullnet nga qeveria dhe akademia.

“Janë pasoja të standardit. Para vitit 1944 Fishta kuptohej edhe në jug dhe e ndiqnin me shumë interes. Paskajorja është mënyrë shumë e rëndësishme është përjashtuar e ke para 1944-ës edhe në toskërisht. E ke edhe te Naimi ‘Bagëti e Bujqësi’, nuk ishte diferencë e madhe po shkonte drejt shkrirjes dhe kanë kaluar 50-60 vjet dhe njerëzit janë mësuar te mos lexonin Fishtën dhe autorë të mëdhenj. Gjuha gjallërohet duke




hapur standardin, duke i fut në libra e duke patur guxim. Edhe shkrimtarët veriorë kanë vetëcensurë. Po përvetësohen shprehje nga gjuhë të huaja; sa bukur do të përvetësoheshin format e shqipes, brenda Shqipërisë. Duhet vullnet. Nuk shoh vullnet as nga akademia e qeveria”.

Ai sjell në vëmendje konferencën gjuhësore në Durrës në 2010 ku akademikë nga trevat shqiptare sugjeronin mundësinë e futjes së paskajores në standard, por që një grup gjuhëtarësh nxituan të hartonin një rezolutë kundër saj. “Në 2010 u bë një konferencë gjuhësore në Durrës dhe ishin akademikë nga trevat shqiptare dhe miratuan përmbledhje ku sugjeronin me pa mundësinë e futjes së paskajores në standard. Sa u mor vesh kjo një numër gjuhëtarësh vrapojnë te njëri tjetri dhe hartuan një rezolutë kundër paskajores. Ky zell kundër gjuhës shqipe nuk është ndaj strukturave

gjuhësore të huaja dhe fjalëve krejt të panevojshme. Paskajorja quhet forma më e lartë e mendimit abstrakt në një gjuhë. Ka rrjedhshmëri të madhe. Është një vlerë që e ka 70 për qind e gjuhës shqipe; e kanë të gjitha gjuhët evropiane. Është një humbje madhe”.

Edhe pse nuk sheh dritë jeshile për reformimin e standardit, gjuhëtari Elezi nuk i humb shpresat, që brezat e ardhshëm do të gjejnë mirëkuptimin për rëndësinë e gjuhës shqipe.

“Është e mundshme nuk e mendoj se do ketë gjithnjë mosmarrëveshje, që e kuptojnë rëndësinë e problemit dhe duhet të bëjnë diçka. Nuk e quaj pa zgjidhje. Për momentin nuk shoh dritë jeshile. Problemi është serioz dhe mungesë vullneti. Edhe në Kosovë janë të ndarë. Gjuhën e kemi gjithçka, ADN, qenie, identitet, prandaj ta hapim që të përfshijë gjithë qenien e saj”.



EUROGLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Bale shpëton Uellsin nga humbja, Holanda mposhti Senegalin

AL RAYYAN, 21 NËNTOR - Barazimi i parë i Botërorit të Katarit erdhi pikërisht këtë të hënë mbrëma, teksa ndeshja mes ShBA-së dhe Uellsit, e luajtur në Al Rayyan nuk shkoi më shumë se barazimi 1-1. Goli i parë i sfidës do vinte në minutën e 36-të nga Timothy Weath. Ky gol i Weath thyen rekord, pasi ai bëhet djali i parë i një kreu shteti që luan në një Botëror dhe që shënon gol. 22-vjeçari është i biri i Presidentit të Liberisë, George Weah, i cili mbahet mend për faktin se ka veshur fanellën e Milanit. Gareth Bale nuk ishte në ditën e tij më të mirë, gjithësi ndihmoi përfaqësuesen e tij me një gol, pas një ekzekutimi të një penalltie. Me këtë rezultat, të dyja skuadrat mbeten në lojë për një biletë për të kaluar tutje, në një grup me Anglinë dhe Iran. Në ndeshjen



tjetër, Holanda ka vuajtur shumë përballë Senegalit të cilët i hapën mjaft telashe. Megjithatë tulipanët arritën të marrin tri pikë, duke i mposhtur 0-2. Pas një pjese të parë pa gola, duhet të vinte minuta e 85-të që tulipanët të

zhbllokoni sfidën me anë të sulmuesit të PSV-së Cody Gakpo i cili realizoi me kokë, ndërsa Klaassen dyfishoi në shtesa. Ekipi i Van Gal ngjitet në vendin e parë me tri pikë, po aq sa ka dhe Ekuadori që mposhti dje Katarin



vendas. Ndërkohë, në ndeshjen e radhës Holanda luan ndaj Ekuadorit, ndërsa Senegal ndaj Katarit. Pas ndeshjes mesfushori I Holandës, Freink De Jong është hprehur optimist se holandezët mund të fitojnë Kupën e Botës.

“Në përgjithësi, ne nuk ishim shumë të mirë sot, por në aspektin defensiv, ne nuk i lamë mundësi kundërshtarit. Ne mund ta fitojmë Kupën e Botës, jemi një nga skuadrat e mira në Kampionat”, ka shtuar De Jong.

Anglia e nis fuqishëm Botërorin, shkatërron 6-2 Iranin

DOHA, 21 NËNTOR - Kombëtarja e Anglisë e ka nisur në mënyrën më të mirë rrugëtimin në Kupën e Botës, duke fituar 6:2 kundër Iranit, në kuadër të Grupit B. Bellingham ka zhbllokuar rezultatin në minutën e 35-të duke ua dhënë epërsinë e parë anglezëve. Tetë minuta më vonë golin e qetësisë e ka shënuar Saka (43'). Epilogun e pjesës së parë të lojës e ka vulosur Sterling në minutën e parë shtesë. Anglezët e kanë nisur më mirë edhe pjesën e dytë me Sakan, i cili

ka shënuar golin e dytë personal dhe të katërtin për “Tre Luanët”. Më pas Irani është kundërpërgjigjur me golin e Taremit. Rashfordi është përkujdesur për golin e katërt në minutën e 71-të, kurse të pestin e ka konkretizuar Grealisht në minutën e 90. Krejt në sekondat e fundit Irani ka gjetur golin e dytë me anë të Taremit nga penalltia. Anglia dhe Irani janë në Grupin B me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Uellsin, takimi i të cilëve luhet sonte me fillim nga ora 20:00.



Superkupa e basketbollit zhvillohet në Prishtinë



PRISHTINË, 21 NËNTOR - Edicioni i Superkupës së Kosovës do të zhvillohet në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë. Kështu ka vendosur të hënën bordi i Federatës së

Basketbollit të Kosovës. “Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) më 21.11.2022 e ka shqyrtuar ofertën e KB Sigal Prishtina për organizimin e Superkupës së

Kosovës me datat 07-11 dhjetor 2022 në Prishtinë, njëherësh e ka miratuar këtë ofertë si dhe e ka udhëzuar KB Sigal Prishtina që t’i fillojë përgatitjet për këtë event madhështor konform

udhëzuesit për organizimin e Superkupës së Kosovës”, është thënë në vendimin e FBK-së. Ndishjet do të zhvillohen nga data 7 deri më 11 dhjetor.

Hajdari për ndeshjet me Poloninë: Gjithçka është e mundur

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Organizatorja e lojës së Kombëtares së Kosovës në hendboll, Marigona Hajdari, vlerëson ndeshjet me Poloninë, që janë në prill të vitit të ardhshëm. Ndishjet në Poloni dhe Kosovë do të vendosin se cila prej këtyre ekipeve kombëtare do të kualifikohet në Botërorin 2023. Natyrisht,

Polonia vlerësohet favorite, por Hajdari thotë se çdo gjë e mundur. Kombëtarja jonë është në ngritje, kurse Marigona ka pjesën e vet të meritave për këtë. Ajo shquhet me organizimin shembullor të lojës. “Natyrisht që shorti vlerësohet i vështirë. Polonia vazhdimisht merr pjesë në Kampionate Botërore dhe Kampionate Evropiane. Dihet

që ka lojtare me shumë përvojë dhe kualitet. Do të jetë shumë e vështirë për ne, por edhe ne jemi përmirësuar shumë kohën e fundit. Dhe mos të harrojmë se në sport çdo gjë është e mundur”, ka thënë Hajdari. Ajo u është kthyer obligimeve në klubin e elitës daneze, Ringkobing, pasi me Kosovën eliminuan Ishujt Faroe.



Verstappeni: Sezon i jashtëzakonshëm, por vështirë se mund të përsëritet

ABU DHABI, 21 NËNTOR - Max Verstappeni arriti në pistën e Yas Marina, në Abu Dhabi, fitoren e 15-të sezonale, rekord absolut i fitoreve të arritur nga një pilot në një sezon të vetëm. Piloti holandez i Red Bullit siguroi titullin e dytë kampion

bote këtë sezon. "Ishte vërtet e jashtëzakonshme të punosh me këtë skuadër dhe të përsëritësh të njëjtin rezultat si vitin e kaluar. Ky sezon u vendos nga mënyra e menaxhimit të gomave dhe Red Bulli u tregua superior karshi

rivalëve. Të arrish 15 fitore është diçka e jashtëzakonshme, por vështirë se kjo gjë do të përsëritet vitin tjetër", ka thënë Verstappeni. "Ishte një sezon i ndërlikuar, që nuk nisi mirë, por gradualisht rikuperuam dhe më pas menaxhuam me

kujdes gjithçka. Edhe rivalët tanë bënë gabime. Por vitin tjetër presim një betejë edhe më të fortë, pasi edhe Mercedesi do të jetë në duel me ne dhe Ferrari. Ndaj duhet kujdes që nga fillimi", ka deklaruar Verstappeni.



Fillon Liga e Veteranëve

PRISHTINË, 21 NËNTOR - Të dielën ka filluar Liga e Veteranëve. Kjo është hera e parë që po organizohet Liga e Veteranëve te meshkujt, ndërsa më pas do të vazhdohet edhe te femrat. Në këtë ligë po marrin pjesë gjashtë skuadra. Të dielën garat u zhvilluan në Therandë, ndërsa më pas do të vazhdohet në qytetet e tjera. Hapjen e garave e ka bërë kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu. I pari i basketbollit të Kosovës, duke i përshëndetur të pranishmit, kujtoi se kjo gjeneratë para dhe pas luftës ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në basketbollin e Kosovës dhe kjo ligë po organizohet për t'i nderuar



REZULTATET - JAVA 1

Golden Eagle Ylli - Trepça	45-39
Vëllaznimi - Prishtina	29-42
Peja - Bashkimi	34-36

veprat e tyre. Fetahu shtoi se janë krenarë që po përkrahin këtë ligë. Edhe kryetari i komunës së Therandës, Bali Muharremi, falënderoi kryetarin e FBK-së për pjesëmarrjen në këtë organizim

dhe klubet pjesëmarrëse. Ndashjet ishin interesante, ku veteranët sërish u rikthyen në aksion, ndërsa pas përfundimit Jeton Kuqi është shpallur MVP i xhiros së parë.

Lakersat fitojnë pa LeBronin, triumfojnë edhe Golden State, Phoenixi dhe Brooklyn

LAKERS, 21 NËNTOR - Fitorja e tretë radhazi për skuadrën e lakersave, që duket se ka larguar krizën, duke mundur me rezultat 123-92 San Antonion. Tjetër ndeshje e mirë e Davisit, autor i 30 pikëve e 18 reboundeve, lider në fushë. Fiton edhe Phoenixi ndaj New Yorkut (116-95), duke u ngjitur në vendin e dytë në Perëndim (u dalluan Payne me 21 pikë e Bookerit me 20 pikë). Pa probleme fitoi skuadra e Brooklynit, që mundi me rezultat 127-115 Memphisin, në një ndeshje të dominuar nga Nets, ku të gjithë titullarët realizuan mbi 10 pikë



(Duranti me 26 pikë më i miri). Fitorja e gjashtë radhazi për Sacramento, që mundi me shifrat 137-129 Detroitin, me Foxin protagonist në fushë, autor i 33 pikëve. Zhgënjën sërish Miami, që kësaj radhës pësoi humbje nga Clevelandit (113-97), ndeshje ku u

dallua Garlandit me 25 pikë. Fiton edhe kampionët e Golden States, që falë 41 pikëve të Klay Thompsonit, mundën me shifrat 127-120 Houstonin jashtë fushës. Fitore në sekondën e fundit për Denverin, që mundi me rezultat 98-97 Dallasin (Hyland 29 pikë).

REZULTATET

Phoenix - New York	116-95
Washington - Charlotte	106-102
Sacramento - Detroit	137-129
Washington - Charlotte	106-102
Brooklyn - Memphis	127-115
Cleveland - Miami	113-87
Houston - Golden State	120-127
Dallas - Denver	97-98
Lakers - San Antonio	123-92

Vetëvritet futbollisti zviceran

Futbollisti i Zrinjskit nga Mostari, Karim Gazeta, është vetëvrasë, raporton Klix.

Futbollisti zviceran ka mbërritur në Zrinjski këtë verë si një përforsim i madh nga

Xamax, që është edhe angazhimi i tij i parë i huaj, pasi gjatë gjithë jetës luajti në

vendlindje. Gazeta ka luajtur vetëm një ndeshje për Zrinjskin këtë vit, ndonëse dikur

konsiderohej si një talent i madh në futbollin zviceran. Nuk dihen ende arsyet e vetëvrasjes.

SHKURT

Ademi paralajmëron ardhjen e Ronaldos në Kosovë

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka paralajmëruar ardhjen e ish-sulmuesit brazilian, Ronaldo Nazario, në Kosovë. Së paku kështu ka lënë të kuptohet i pari i FFK-së në postimin e tij në "Facebook", ku ka bërë me dije se është takuar me 'Fenomenin' në Katar, atje ku po zhvillohet Kampionati Botëror i futbollit. Ai ka thënë se bashkë me brazilianin diskutuan për vizitën e parë të Ronaldos në vitin 1999 si dhe e ka ftuar që ta vizitojë Kosovën, ftesë të cilën, sipas Ademit, ai e ka pranuar me kënaqësi. "Pas ndeshjes hapëse të Kupës së Botës 2022, Katar - Ekuadori, e takova fenomenin Ronaldo Luis Nazario de Lima. E kujtuam vizitën e tij të parë menjëherë pas përfundimit të luftës në vitin 1999. Ftesën time për ta vizituar sërish Kosovën, fenomeni e pranoi me kënaqësi", ka shkruar Ademi. I pari i Federatës së Futbollit nuk ka zbuluar se kur mund të realizohet kjo vizitë.

Reja e mbylli me Shqipërinë, tre emra në listë për trajner

Edi Reja e mbylli me kombëtaren kuqezi, zbulohen emrat potencialë për bankinën e Shqipërisë. Ndashja me Armeninë ishte e fundit për Edi Rejen në drejtimin e Kombëtares shqiptare. Shumë emra të tjerë janë përfolur muajin e fundit si kandidatë për të marrë stolin e kuqezinjve. Nga Luigi Di Biaggio, Esteban Cambiasso, i cili ishte për vizitë edhe në Tiranë, apo Marco Giampaolo, që është një preferencë e presidentit Armand Duka. Po ashtu, edhe Besnik Hasi, që është përfolur shumë, ka dalë sërish në skenë për ta drejtuar ekipin kombëtar.

Ronaldo: Mjaft folët për mua, kam dhënë prova se kush jam

Cristiano Ronaldo foli në prag të ndeshjes së parë të Kupës së Botës, ndërkohë që është përpjekur t'i harrojë problemet që po kalon te Manchester United. "Nuk kam dyshim se ky episod i fundit, ajo intervistë dhe episode të tjera me lojtarë të tjerë që ndodhin ndonjëherë, ndonjëherë mund ta tronditin lojtarin, por nuk do ta tronditin kurrë ekipin. Koha i qartëson gjithmonë gjërat. Secili e di vetë kur e zgjedh kohën e tij. Ndonjëherë shkruhen të vërteta e herë ta tjera gënjeshtër. Nuk kam pse të shqetësohem për atë që mendojnë të tjerët. Unë flas kur dua. Të gjithë e dinë se kush jam, çfarë besoj", ka deklaruar Ronaldo.

Trajneri i Argjentinës: Kemi një grup të vështirë

Argjentina bën pjesë në Grupin C së bashku me Poloninë, Meksikën dhe Arabinë Saudite, një grup që për trajnerin Scaloni nuk është aspak i lehtë: "Grupi ynë është një grup i vështirë, mbi të gjitha është e komplikuar ndeshja e parë, kjo edhe për shkak të orarit. Në orën 11:00 këmbët mund të jenë të forta, të mos harrojmë edhe rivalët tanë, Arabia luan një futboll të mirë. Në këtë grup kemi Meksikën, një rival yni historik dhe i ndërlikuar për ne, më pas është Polonia, një skuadër tipike evropiane, me lojtarë të gjatë dhe të fortë, me një Lewandowski që është nga sulmuesit më të mirë në botë".

NJOFTIM

Njoftohen blerësit e interesuar se kompania Solid Company, me numër unik 810385692, me adresë Milloshevë, Obiliq, shpall **likuidimin e sasive të përgjithshme të stokut për produktin Kushineta 6308 II RS, sasia 29,780.00 kg.**

Duke qenë se produkti ka më shumë se 13 vjet në magazinë, ai gradualisht është shkatërruar duke humbur vetitë e tij dhe në mas të madhe ka korrezion, rrjedhimisht nuk është përdorur pasi që është në formë mbetjesh, dhe ky produkt mund të përdoret vetëm për riciklim, po ashtu është paraqit nevoja që materiali të largohet nga magazina për të liru hapësirë.

Andaj, në mbështetje të udhëzimit administrativ 15/2010 - Shitje me lirim, neni 26, ky material shitet me çmimin e ulur të shitjes.

OBAVEŠTENJE

Obaveštavaju se zainteresovani kupci da kompanija Solid Company, sa jedinstvenim brojem 810385692, sa adresom Miloševo, Obilić, objavljuje likvidaciju opštih količina zaliha za proizvod Kušineta 6308 II RS, količina 29.780,00 kg.

Pošto se proizvod nalazi na skladištu više od 13 godina, postepeno je uništavan gubitkom svojih svojstava i ima veliku količinu ispravki, stoga nije neiskorišćen jer je u obliku otpada, a ovaj proizvod može samo da se koristi za reciklažu, postoji i potreba da materijal napusti skladište kako bi se oslobodio prostor.

Dakle, u prilog administrativnom uputstvu 15/2010 – Prodaja sa izuzetkom, član 26, ovaj materijal se prodaje po sniženoj prodajnoj ceni.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania "Studio Lina" SHPK, rruga 12 Qershori p.n. Ferizaj, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër unik identifikues: 811960071 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditore nga data e shpalljes .

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the joint stock company "Studio Lina" LLC str. 12 Qershori in Ferizaj, has come to the decision to quit its business with registry: 811960071. The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgager- mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of the announcement publication.

OBAVESTENJE

Obavestavaju se svi klienti da poduzeća, "Studio Lina" DOO, ulica 12 Qershori Urosevac, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom po broj registra: 811960071 ujedno imenovao likfidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Egzona Maloku shpall të pavlefshme dëftesën e kl. njëmbëdhjetë të shkollës së mesme "Shtjefën Gjeçovi" Prishtinë.

- Hafiz Sylejmani shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të I të shkollës së mesme "Shtjefën Gjeçovi" Prishtinë.

- Çlirim Haziri shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme si dhe diplomën e Gjimnazit "Sami Frashëri" Prishtinë.

- Ardiana Golaj nga Gjakova shpall të pavlefshme Diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Zgjim Bytyqi nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e testit të maturës të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Naim Sadrijaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U "Haxhi Hoti" Rogov KK Gjakovë nga kl. I-VIII.

- Rexhep Sadrijaj nga Ujë KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U "Haxhi Hoti" Rogovë KK Gjakovë nga kl. I-VIII.

Durim Sadrijaj nga Ujë KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U "Pjetër Bogdani" Pnish KK Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të Rregullorës për Procedurat e Rekrutimit, Marrëdhënien Kontraktuale dhe Avansim në Detyrë në Ndërmarrjen Publike Banesore, nr. 01-499/2, datë 01.04.2021 shpall:

KONKURS Për plotësimin e vendit të punës

Titulli: Konsulent/e i/e jashtëm/e për harmonizimin e rregulloreve të brendshme, manualeve të punës dhe akteve tjera nënligjore (2) pozita

Nr. i referencës

I raporton: Kryeshefit Ekzekutiv

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kompensimi: 800 euro (Bruto) në muaj

Kohëzgjatja e kontratës me afat të caktuar: 12 muaj me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin harton planet e punës për zbatimin e detyrave të caktuara në bazë të objektivave, si dhe jep rekomandime për zbatimin e këtyre objektivave;
- Vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon menaxhmentin e lartë për ndryshime/përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
- Propozon nxjerrjen e akteve nënligjore për përmirësimin e procesit të punës në ndërmarrje si rregullore, urdhëresa e urdhra;
- Kujdeset për trajtimin e çështjeve konkrete mbi kërkesat të cilat i përcillen për shqyrtim nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv dhe raportimin para tij për përfundimin apo për probleme që lidhen me procesin e shqyrtimit të tyre;
- Raportimi javor, mujor tek mbikëqyrësi.

Kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën ekonomike, juridike, menaxheriale, administrates ose relevante;
- Përvojë pune së paku 5 vjeçare;
- Përvojë 2 vjeçare të dëshmuar menaxheriale.

Aftësitë:

- Njohje e sektorit publik lokal/qendror;
- Aftësi për punë ekipore;
- Aftësi të shprehura komunikimi;
- Njohje bazë e gjuhës angleze;
- Të ketë etikë në punë dhe integritet të lartë.

Kualifikime tjera:

- Preferohet përvojë në koordinim dhe zbatim të projekteve;
- Kurset dhe trajnimet tjera profesionale gjate karrierës.

Procedura e Konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyret e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën:

www.npbanesore.com/shpalljet/mundesi-punesimi/. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në

Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: rr. Zija Shemsiu, nr. 22, Ulpianë - Prishtinë, të aplikojnë përmes emailit zyrtar: burimet.njerezore@npbanesore.com apo përmes postës. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur;

- Formulari për aplikim i NPB-së;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor;
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën nga gjykata e cila dëshmon që nuk është i/e dënuar (jo më e vjetër se gjashtë muaj).

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda dy (2) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËRKESAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË SHPALLJE SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHOYRTOHEN.

Shpallja është e hapur që nga data: 21.11.2022- 25.11.2022

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel. : 038 553 311.



Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Na osnovu Uredbe o postupku zapošljavanja, ugovornom odnosu i napredovanju u javnom stambenom preduzeću, br. 01-499/2 od 01.04.2021. godine objavljuje:

KONKURS Da popuni radno mesto

Zvanje: Spoljni konsultant za usaglašavanje internih propisa, priručnika za rad i drugih podzakonskih akata (2) pozicije

Ne. referentnog

Podnosi izveštaje: Izvršnom direktoru

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Naknada: 800 evra (bruto) mesečno

Trajanje ugovora na određeno vreme: 12 meseci sa mogućnošću produženja

Dužnosti i odgovornosti:

- u saradnji sa rukovodiocem izrađuje planove rada za realizaciju određenih zadataka na osnovu ciljeva, kao i daje preporuke za realizaciju ovih ciljeva;
- Ocenjuje interne procese i procedure i preporučuje promene/poboljšanja višem rukovodstvu u cilju povećanja efikasnosti i kvaliteta rada;
- Predlaže donošenje podzakonskih akata za unapređenje procesa rada u preduzeću kao pravilnike, uredbe i naredbe;
- staranja o rešavanju konkretnih pitanja po zahtevima koji se upućuju na razmatranje od strane glavnog izvršnog direktora i izveštavanje o zaključcima ili problemima u vezi sa procesom njihovog razmatranja;
- Nedeljno, mesečno izveštavanje nadzornika.

Kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma u ekonomskim, pravnim, menadžerskim, administrativnim ili relevantnim oblastima;
- Radno iskustvo od najmanje 5 godina;
- 2 godine dokazanog menadžerskog iskustva.

veštine:

- Poznavanje lokalnog/centralnog javnog sektora;
- Timski rad veštine;
- Izražene komunikacijske veštine;
- Osnovno znanje engleskog jezika;
- Da ima radnu etiku i visok integritet.

Ostale kvalifikacije:

- Poželjno je iskustvo u koordinaciji i implementaciji projekata;
- Kursevi i druga stručna usavršavanja tokom karijere.

Procedura konkursa

Zainteresovani kandidati mogu dobiti zvaničan formular u Službi za ljudske resurse Javnog stambenog preduzeća ili ga preuzeti sa sajta na adresi: www.npbanesore.com/shpalljet/mundesi-punesimi/. Dokumentacija se može dostaviti u fizičkoj kopiji Sektoru za ljudske resurse na adresu: ul. Zija Šemsiu, br. 22, Ulpiane - Priština, da se prijavište putem zvanične e-pošte: svere.njerezore@npbanesore.com ili putem pošte. Kandidati koji konkurišu moraju tačno da unesu adresu, kontakt telefon i mejl adresu. Na intervju će biti pozvani samo izabrani kandidati.

Prijava mora biti priložena;

- obrazac prijave za NPB;
- dokaze o školskoj spremi;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Kopija lične karte;
- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije osuđivan (ne starije od šest meseci).

Napomena: Prijave poslate poštom sa poštanskim žigom poslednjeg dana roka za prijavu smatraće se validnim i razmatrane ako stignu u roku od dva (2) dana. Prijave koje pristignu nakon ovog roka i one nepotpune sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.

NEKOMPLETNE PRIJAVE I DOKUMENTACIJA PREMA USLOVIMA NAVEDENIM U OVOM OGLASU I PRISLEPE NAKON KONKURSNOG ROKA NEĆE SE RAZMATRATI.

Oglas je otvoren od: 21.11.2022 - 25.11.2022.

Za detaljnije informacije možete se obratiti Odeljenju za ljudske resurse Javnog stambenog preduzeća na br. tel. : 038 553 311.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1908

Columbus, Georgia, USA
Since 1908
0.5L